



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 801/₁ prot.

Tiranë më 7.2.2020

Lënda: Kthim përgjigje.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 4798 Prot., datë 30.06.2020, Zyra e Komisionerit paraprakisht sqaron se transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale realizohet në përputhje me parashikimet e neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), vendimin nr. 8, datë 30.01.2016, i Komisionerit “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave” (në vijim, “Vendimi nr. 8”), si dhe udhëzimin nr. 41, datë 13.06.2014, të Komisionerit “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale” (në vijim, “Udhëzimi nr. 41”).

Sa më sipër, pika 1 e nenit 8 të Ligjit përcakton se “Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendim të Komisionerit.”

Në rastin e vendeve që nuk kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, transferimi ndërkombëtar i të dhënave drejt këtyre vendeve, kryhet në bazë të pikës 2 të nenit 8 dhe nenit 9 të ligjit, si dhe në Udhëzimin nr. 41.

Në këtë kontekst, dispozitat e akteve të sipërpërmendura përcaktojnë se transferimi i të dhënave personale drejt vendeve me nivel të pamjaftueshëm të mbrojtjes së tyre realizohet, ndër të tjera, me pëlqimin e subjektit të të dhënave (germa “a” e pikës 2 të nenit 8), kur autorizohet nga akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe që janë të

zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë (germa “b” e pikës 2 të nenit 8), apo me autorizim të Komisionerit (neni 9).

Në lidhje me rastin konkret, Zyra e Komisionerit, me shkresën e saj me nr. 638/1 prot., datë 10.05.2019, ka sugjeruar një riformulim lidhur me termin “*të dhëna personale*” në tekstin e Memorandumit, pa u ndalur në aspektin formal të mjeteve, instrumenteve apo kanaleve të komunikimit midis palëve në Memorandum lidhur me shkëmbimin e informacionit, pasi, në bazë të Vendimit nr. 8, është konstatuar se Mbretëria e Bashkuar është vend me nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale.

Rrjedhimisht, nisur nga perspektiva e vlerësimit të përputhshmërisë së transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, sipas Memorandumit dhe protokollit të tij ndryshues, Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo kategori përpunimi është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në këtë rast, Ligji nuk e kushtëzon transferimin ndërkombëtar me ekzistencën e një instrumenti të caktuar me fuqi detyruese (siç është rasti i marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar me ligj).

Nga ana tjetër, mënyra dhe aspekti formal-procedural i bashkëpunimit i Ministrisë së Brendshme me partnerët e saj (të vendosur në vende me nivel të mjaftueshëm të mbrotjes së të dhënave personale), për qëllime dhe/ose në fusha të caktuara sipas detyrave institucionale të saj, nuk është objekt i veprimtarisë monitoruese dhe mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

